



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ardian Behra	09.10.2023	20.10.2023	2023/0754

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2023, OE “AWA SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0754, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Blendi.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Pajisje- Elemente Sportive per Sallen Edukative Fizike ne AKSP” me nr. të prokurimit: "214-23-7609-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 29,500.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0754 i dt:02.10.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Neni 1- Qëllimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 10.1 i RRUP nr 001/2023- Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

KRITERET PËR VLERËSIM

	<p>Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p>1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1.Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2</p>
	<p>2.Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.</p>	<p>2.Vërtetim nga Administrata Tatimore - (duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës.</p>
	<p>3.Vërtetim nga Gjykata</p>	<p>3.Vërtetim nga Gjykata</p>

	3.Vërtetim nga Gjykata	3.Vërtetim nga Gjykata
Furnizim- Procedur e Hapur		13
214 23 17 121– Titulli : <i>Furnizim me pajisje – Elemente Sportive për Salën Edukative Fizike në AKSP</i>		
	<p>Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e pershtatshmerise” - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.</p>	<p>Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – (duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës - Original ose kopje e vërtetuar).</p>
	<p>4.Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepr penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.</p>	<p>4.Vërtetim nga Gjykata Themelore – (duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës - Original ose kopje e vërtetuar).</p>

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale	<i>Dëshmia e kërkuar</i>
		1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës).	1.Kopja e regjistrimit të
		2.Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)	2.Kopja e certifikatës
		3.Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore)	3.Kopja e certifikatës fiskal

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me pajisje – elemente sport edukative fizike në AKSP

Numri i aktivitetit të prokurimit: 214-23-7609-121, dhe nr. i brend.: 214 23 17 121.


Radhë	Lënda / grupi	Çmimi total i ofertës (TVSH)
1.	„EU1 Servis” Sh.p.k. – Vushtrri	29.360,00 €
2.	„AVA” Sh.p.k. - Prishtinë	24.367,00 €
3.	„Fatmir Godeni B.I. “ - Prizren	29.250,00 €
4.	N.T.G., „Blendi” O.P. – Prishtinë	27.371,00 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike shpërblen me kontratë N.T.G., „Blendi” O.P. në vlerë 27.371,00 euro.

Data: 15.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Bekim Dakaj



INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - AWA SH.P.K.

AK/Zyra e prokurimit gjatë vleresimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/ AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE me 15.09. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e AK, kompania jone është eliminuar me arsyetimin se na mungon autorizimi i prodhuesit. AK para se të vendos për eliminimin e ofertes sone ka mund të kërkojë sqarime shtese për autorizim, ne posedojmë autorizimin e prodhuesit dhe është leshuar para datës së aplikimit për projektin në fjalë. Për shkak të gabimit teknik gjatë dorëzimit të ofertes nuk është ngarkuar autorizimi në e-prokurim, të dokumentet e ofertes kemi dorëzuar një file tjetër dokumentet autorizimi për ofertim dhe personi përgjegjës në administratë i cili ka dorëzuar ofertën ka menduar se në këto dokumente ka bashkangjitur autorizimin e leshuar nga prodhuesi.

Sqarim i Ekspertit;

Gjatë verifikimit të shkresave të lëndës eksperti ka verifikuar që OE ankues ka prezanduar një autorizim nga Kompania Vlera Sport LTD sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, e cila ka autorizuar kompanin AWA sh.p.k që të ofertojë për projektin në fjalë. Anda, rekomandoj që ky pretendim i ankesës të aprovohet dhe AK, në këtë rast mundet sipas Nenit 66, si dhe Udhëzuesit Nr. 001/2023, të kërkojë sqarime informata sqaruese për autorizim.

AK duke u thirrur në nenin 72.3 të LPP-se dhe nenin 10.1 të udhëzuesit për prokurim publik para se të vendos për eliminimin e kompanisë sone ka mund të kërkojë sqarime shtese autorizimin. Citoj nenin 72.3 të LPP-se 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Citoj nenin 10.1 të RRUOPP Mungon licenca Mund të kërkojnë informata sqaruese 66 Mungon certifikata ISO Mund të kërkojnë informata sqaruese 69 Duke marrë parasysh se vlerësimi i ofertave ka zgjatur nga data 18.08. deri më 15.09. AK ka mund të sqarojë këto detaje para se të eliminojë ofertën tonë.

Sqarim;

Eksperti shqyrtues mendon që kjo pikë e ankesës aprovohet si e bazuar duke ju referuar Nenit 69 të LPP-së, si dhe Udhëzuesi Nr. 001/2023 për Prokurim Publik pika 10.1, kur Mungon certifikata ISO, mund të kërkojnë informata shtesë nga autoriteti kontraktues.

Neni 1- Qellimi dhe neni 6 i LPP-se- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti obligon autoritetin kontraktues që fondet publike të shpenzohen në mënyrë sa më të racionalë dhe ekonomike, AK

konform nenit 72.3 të LPP-se dhe RRUOPP para se të vendos për eliminimin e ofertes sone ka mund të kërkojë sqarime shtese autorizimin më parash dhe faktin se jemi oferta me e lire e dorezuar në këto aktivitet të prokurimit dhe AK në këto forme do të kursente parane publike perkatesisht buxhetin e AKSP për 3004.00euro. AK në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim ka cekur se kompania jone nuk ka interes material-juridik nga ky projekt por vetëm jemi duke e prolonguar projektin, ky konstatim i AK nuk qëndron kompania jone ka dorezuar ofertën me të lire për këto aktivitet të prokurimit dhe synon të nënshkruajë kontratë me AK kjo është dhe arsyeja e kërkesës për rishqyrtim, AK para se të eliminojë ofertën e kompanisë sone është dashur që konform dispozitave ligjore të lartcekura të kërkojë sqarime shtese. Në nuk kemi pretendime ankimore ndaj OE tjer pjesmarrës mirepo po kërkojmë të na lejohet e drejta jone pasi që jemi oferta me e lire për këto aktivitet të prokurimit dhe nuk qëndron pretendimi i AK se kemi synim prolongimin e projektit.

Sqarim i Ekspertit lidhur me pretendimet ankimore të OE;

Eksperti Shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore për mungesën e autorizimit të prodhuesit, si dhe mos prezantimit të certifikatës ISO, sipas kërkesave të AK. Rekomandohet që për këto pika të ankesës të pranohen si të bazuara në këtë rast dhe AK, duhet që të shterr të gjitha mundësit, para se ta eliminojë OE më të lirë, si të përgjegjshëm, duke ju referuar nenit 72, pika e 3; Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentat ekzistencë e të cilave është fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyr objektive. Pra në këtë rast Autoriteti Kontraktues të veprojë në baz të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullorëve të Prokurimit Publik që janë në fuqi, duhet të kërkojë sqarime për këto dy pretendime para se ta eliminojë OE.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AWA SH.P.K.**

Ardian Behra

